

RRETH FJALORIT TË ORIENTALIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

Në vitin 2005 doli nga shtypi në Tiranë, me nismën dhe përkujdesjen e Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, një vepër e pritur prej kohësh e dijetarit të palodhur shqiptar, Tahir N. Dizdarit, me titullin *"Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe"*. Kjo vepër, që është fryt i një pune të gjatë të kryer me një pasion të admirueshëm dhe me një akribi shkencore shembullore në kushte jetësore shumë të vështira, kishte njohur më parë ndonjë botim të pjesshëm qysh me gjallje të autorit dhe pikërisht në revistat "Buletin për Shkencat Shoqërore" dhe "Studime Filologjike" të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave (gjatë vjetëve 1960 – 1966), si edhe pas vdekjes së tij në revistën "Perla".¹ Por autori mjerisht nuk arriti ta shihte të botuar në një vëllim të posaçëm të gjithë frytin e punës së tij sa të gjatë e të lodhshme, aq edhe të çmuar, e kjo është një nga rastet e rralla, që tregojnë se ç'mund të bëjë një studiues i vendosur për t'ia përkushtuar tërë jetën, edhe në kushte jetësore gati të papërfytyrueshme, një qëllimi fisnik shkencor. Prandaj, botimi i kësaj vepre të vëllimshme dhe plot vlera të Tahir N. Dizdarit jo vetëm që plotëson një nevojë të madhe për të gjithë ata studiues që i janë përkushtuar studimit të thelluar të gjuhës shqipe, por është edhe një shenjë nderimi për punën e vlefshme dhe të palodhur të një dijetari fjalëpak e punëshumë.

Edhe nga një vështrim i shpejtë i këtij vëllimi prej 1200 faqesh, studiuesi bindet për punën e madhe të Autorit në shumë drejtime, duke nisur nga qëmtimi dhe grumbullimi i lëndës së shqyrtuar me aq kujdes e duke vazhduar me përcaktimin e burimit (turk, arab, persian etj.) të fjalëve të shqyrtuara, me përdorimin e këtyre edhe me kuptime të ndryshme në kontekste dhe vise të ndryshme, me ndryshimet shpesh jo të vogla fonetike e kuptimore që kanë pësuar në gjuhën shqipe huazimet e quajtura konvencionalisht "orientalizma" etj. Shqyrtimi i gjithë asaj pune të madhe, që ka bërë Tahir N. Dizdari në këtë rast, do

të kërkonte një studim më vete, që i kapërcen caqet e një recensionit. Prandaj, në këtë artikull të shkruar më fort në shenjë nderimi për një studiues të palodhur, që mbetet i gjallë midis nesh me veprën e tij shumë të dobishme, unë do të ndalem vetëm në disa nga vlerat kryesore të saj, duke prekur edhe disa probleme që dalin nga kjo vepër.

Dhe po e nis me vetë emërtimin e këtyre huazimeve. Autori, me sa duket, për të vënë në dukje se në veprën e tij ka përfshirë jo vetëm fjalë të burimit thjesht turk, por edhe të burimeve të tjera, kryesisht prej gjuhëve të Lindjes së Mesme (arabishte dhe persishte), për huazimet në shqyrtim ka përdorur termin "orientalizma". Por ai sqaron me të drejtë se, me pak përjashtime, ato kanë depërtuar në gjuhën shqipe drejtpërdrejt nga turqishtja, d.m.th. me të gjitha ndryshimet e pësuarat "në përshtatje me sistemin fonetik e strukturor të asaj gjuhe". Kuptohet vetiu që Autori në këtë rast ka pasur parasysh jo vetëm fjalët prej burimi turk të mirëfilltë, por edhe ato prej burimi tjetër, sidomos arab e persian, që kanë hyrë në shqipe kryesisht nëpërmjet turqishtes. Natyrisht, huazimet prej burimi arab e persian të depërtuara drejtpërdrejt në shqipe nga gjuhët burimore (arabishte e persishte), duhet të jenë më shumë se tri a katër fjalë, siç mëton Autori në Parathënien e tij (f. 9), por, gjithsesi, numri i tyre ka qenë i kufizuar në një sasi të caktuar fjalësh nga sfera e kulturës, që janë përdorur e përhapur nga një shtresë e vogël njerëzish të edukuar nëpër shkollat turke, siç ishin p.sh. poetët që shkruan me alfabetin arab, si: Ibrahim Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Ismail Pasha Velabishti, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Çami, Haxhi Ethem Bej Tirana, Tahir Boshnjaku, Sheh Maliqi i Rahovecit etj. Të tilla duhet të kenë qenë, ndër të tjera, fjalët *alem*, *rivajet*, *vixhdan* etj. prej burimi arab apo *divan*, *shahname* etj. prej burimi persian.² Gjithsesi, për fjalët e këtij tipi, që në shumicën dërrmuese kanë hyrë në shqipe nëpërmjet turqishtes, termi orientalizma është përdorur me një kuptim më të ngushtë, për të emërtuar huazimet me burim nga gjuhë të tilla të së ashtuquajturës Lindje e Mesme, si turqishtja, arabishtja dhe persishtja, dhe jo me kuptimin e gjerë, që do të përfshinte huazime edhe nga gjuhë të tjera të Lindjes a Orientit. Për më tepër, Autori ka përfshirë në këtë Fjalor edhe fjalë

burimesh të tjera, që kanë hyrë në shqipe nëpërmjet turqishtes, siç është, ndër të tjera, edhe emri i *Stambollit*, që e ka burimin të shprehja greke "eis tçn polin" [= is tin polin = "në qytet"]. Por ai, me sa duket, dashur pa dashur, është pajtuar me përdorimin e termit *orientalizma*, gjithnjë duke qenë i bindur se ato huazime, në përgjithësi, kanë depërtuar në gjuhën shqipe "drejtpërdrejt nga turqishtja"; pra, në të vërtetë, duheshin trajtuar si huazime turke dhe për këtë arsye ai ka vënë shpesh në dukje ndryshimet fonetike, gramatikore dhe kuptimore, që kanë pësuar në turqishte fjalët prej burimi arab, persian etj. Për këtë qëllim, ai, në përgjithësi, për "orientalizmat" e shqipes me burim arab apo persian etj. ka shënuar edhe trajtat burimore të këtyre huazimeve në arabishte, në persishte etj. dhe kjo ia shton edhe më shumë vlerën Fjalorit të tij.

E, megjithëse një studiues i vëmendshëm, nuk e ka të vështirë të dallojë ndryshimet e dukshme, që kanë pësuar fjalët arabe apo persiane, kur janë integruar në gjuhën turke. Nuk më duket e tepërt të theksoj këtu faktin e njohur që turqishtja, si një gjuhë e familjes ural-altaike, ndryshon shumë nga arabishtja (si gjuhë e familjes semite) dhe nga persishtja (si gjuhë e familjes indoeuropiane), si për sa i takon sistemit fonetik, ashtu edhe strukturës gramatikore. Të kihet parasysh, ndër të tjera, se sistemi zanor dhe sistemi bashkëtingëllor i turqishtes ndryshojnë shumë nga sistemet gjegjëse të arabishtes dhe të persishtes. Mjafton të kujtojmë këtu, ndër të tjera, se në turqishte, e cila është mjaft e pasur në zanore,³ ka vepruar ligji i sinarmonisë vokalike, kurse në arabishte, e cila ka më pak zanore (ajo nuk e ka p.sh. zanoren /o/), është zhvilluar kundërvënia "të shkurtra ~ të gjata" midis disa zanoreve. Vlen të përmendet, gjithashtu, se edhe në strukturën gramatikore midis turqishtes dhe arabishtes ka disa ndryshime të rëndësishme. Mjafton të rikujtojmë këtu faktin e njohur që arabishtja e ka pasur të zhvilluar kundërvënien "mashkullore ~ femërore" jo vetëm tek emrat e mbiemrat, por edhe te foljet në vetën e tretë; mbiemrat i rendit rregullisht pas emrit, kurse në turqishte nuk është zhvilluar fare kategoria gramatikore e gjinisë dhe mbiemrat renditen rregullisht para emrit. Gjithashtu, ndërsa arabishtja nëpërmjet nyjës shquese të paravendosur ka krijuar tek emrat

kundërvënien “trajtë e pashquar ~ trajtë e shquar”, turqishtja nuk e ka zhvilluar një kundërvënie të tillë. Prandaj fjalët emra, që turqishtja i ka huazuar nga arabishtja, ia ka përshtatur sistemit të saj gjuhësor, d.m.th. pa kundërvënien “trajtë e pashquar ~ trajtë e shquar”. Ndryshime jo më pak të rëndësishme ka edhe midis turqishtes dhe persishtes. Prandaj, ishte e natyrshme që fjalët arabe dhe persiane që kanë depërtuar në turqishte, të pësonin ndryshimet e nevojshme fonetike e gramatikore në përputhje me rregullsitë e sistemit fonetik dhe të strukturës gramatikore të vetë turqishtes. Mjafton të përmendim këtu, si për shembull, rastin e fjalëve prej burimi persian *çoban* dhe *dert*, që në persishte dalin në njëjës me trajtat *çupan*, përkatësisht *dard* e në shumës me trajtat *çupan-ha*, përkatësisht *dard-ha*, kurse në turqishte dalin me trajtat *çoban ~ çoban-llar*, përkatësisht *dert ~ dert-ler*. Madje, nuk kanë munguar edhe ndryshime të karakterit semantik, por kjo i kapërcen kufijtë e këtij artikulli.

Gjithsesi, si arabizmat, ashtu edhe persizmat që kanë depërtuar në shqipe nëpërmjet turqishtes, kanë hyrë në këtë gjuhë nëpërmjet formave përkatëse të gjuhës turke. Natyrisht, ato huazime, ashtu si edhe fjalët prej burimi turk të mirëfilltë, kur kanë hyrë në gjuhën shqipe, janë integruar këtu në përputhje me rregullsitë e sistemit të kësaj gjuhe. Pra, të ashtuquajturat orientalizma prej burimi arab e persian, kur kanë depërtuar në gjuhën shqipe nëpërmjet turqishtes, i janë nënshtruar një ndryshimi të dytë fonetik e gramatikor. Kështu, këto huazime, ashtu si turqizmat e mirëfillta, janë integruar në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore të shqipes. Mjafton të rikujtojmë këtu se huazimet emra janë integruar në një nga dy gjinitë e gjalla të shqipes (mashkullore e femërore) dhe janë lakuar rregullisht në të dy numrat, si në trajtën e pashquar edhe në të shquarën, ndërsa huazimet mbiemra janë përdorur rregullisht pas emrave.⁴ Edhe mbiemrat, në raste të tilla, ashtu si mbiemrat e tjerë të shqipes, përshtaten me emrin në gjini dhe numër. Nga kjo pikëpamje, ndryshime të dukshme kanë pësuar edhe foljet e çdo burimi të huazuara nëpërmjet turqishtes. Ato, kur kanë hyrë në shqipe, janë zgjedhur rregullisht ashtu si foljet e tjera të kësaj gjuhe. Dhe është një gjë e njohur që zgjedhimi foljor në

turqishte ndryshon shumë nga ai i gjuhës shqipe, por këtu nuk është rasti të ndalemi më gjatë; të interesuarit mund të konsultojnë për këtë veprën e Boretzky-t, I (1975, faqe 248). Këtu po shënojmë vetëm se foljet e huazuara nëpërmjet turqishtes, në shumicën e rasteve, nuk janë integruar në sistemin e zgjedhimit më të gjallë të shqipes, d.m.th. të tipit të zgjedhimit me *-onj* a *-oj*.

Nga Fjalori i Tahir Dizdarit, si edhe nga punimet e autorëve të tjerë, del e qartë se në gjuhën shqipe nëpërmjet turqishtes kanë depërtuar më fort fjalë emra dhe më pak mbiemra, folje dhe pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. E një gjë e tillë nuk është e papritur, sepse është e natyrshme që nëpërmjet kontakteve të përditshme folësit e një gjuhe huazojnë nga gjuhë të tjera, në radhë të parë fjalë që emërtojnë sende konkrete, dhe më pak fjalë që emërtojnë sende abstrakte, cilësi, veprime etj. Gjithsesi, është po kaq e natyrshme që huazimet e të gjitha kategorive t'u nënshtrohen rregullsive fonetike dhe gramatikore të gjuhës huazuese, në rastin konkret të gjuhës shqipe.

Edhe nga një vështrim i shpejtë i veprës së T. Dizdarit, bie në sy një dukuri e turqishtes që është pasqyruar edhe në huazimet e shqipes nga kjo gjuhë, qofshin ato fjalë turke të mirëfillta apo huazime prej burimi arab dhe persian. Në turqishte bashkëtingëlloret pëlçitëse të zëshme /b, d/ dhe afrikatja e zëshme /xh/ në pozicion fundor absolut shurdhohen, por kthehen përsëri në të zëshme, në rast se fjala gjatë lakimit a zgjedhimit ndiqet nga një zanore.⁵ Kështu, p.sh. emrat prej burimi arab *kitab*, *Ahmed*, *Reshid*, *haraxh* etj. dhe *dert* < persisht *dard* etj. në turqishte në rasën emërore e kthejnë fundoren e zëshme në gjegjëset e tyre të pazëshme: *kitab*, *Ahmet*, *Reshit*, *haraç*, *dert* etj. Por në rasën gjinore këta emra e rishfaqin bashkëtingëlloren e tyre të zëshme: *kitab-in*, *Ahmed-in*, *Reshid-in*, *haraxh-in*, *derd-in* etj., kurse në kushte të tjera fonetike nuk rishfaqet bashkëtingëllorja e zëshme, si p.sh. në formën e shumësit *kitab-llar*, *dert-ler* përkundrajt formave gjegjëse të shumësit në persishte *kotab* (sipas arabishtes *kutub*), *dard-ha*.⁶ Në gjuhën shqipe huazimet e këtij tipi kanë hyrë nëpërmjet trajtës së rasës emërore njëjës të turqishtes: *qitap*, *Ahmet*, *Reshit*, *dert*

etj. dhe e ruajnë bashkëtingëlloren fundore të pazëshme gjatë lakimit; pra, ndryshe nga ç'ndodh me raste të ngjashme të burimit jo-turk në të folmet jugore (krahaso: *vënt* ~ *vënd-i*, *vënd-e brek* ~ *breg-u* etj.).

Një meritë e veçantë e Tahir Dizdarit është përpjekja e tij për të qëmtuar e grumbulluar numrin e përgjithshëm të "orientalizmave", a më saktë të turqizmeve që janë përdorur deri sot në burime të ndryshme të gjuhës shqipe. Nga kjo pikëpamje, Fjalori i Tahir Dizdarit përfaqëson numrin më të plotë të regjistruar deri sot të këtyre huazimeve të shqipes. Aty janë përfshirë 4406 huazime të tilla dhe janë vënë në dukje: 553 fjalë të përbëra ose të përngjitura e të sajara brenda truallit të shqipes, si edhe 1541 fjalë të prejardhura e të formuara me prapashtesa ose parashtesa të gjuhës shqipe. Për më tepër, Autori ka vënë në dukje edhe fushat e ndryshme të jetës dhe të kulturës materiale e shpirtërore ku kanë depërtuar këto huazime (shih faqe 10-13). E, po të krahasohen shifrat e Tahir Dizdarit me ato të autorëve para dhe pas tij, bie menjëherë në sy puna e madhe e këtij Autori për grumbullimin e të gjitha "orientalizmave" të shqipes. Kështu p.sh. Gustav Meyer-i në Parathënien e Fjalorit Etimologjik të Gjuhës Shqipe (1891), f. 9 shkruan se ndër 5140 fjalët bazë, që përmban Fjalori i tij, ka 1180 huazime turke, përkundrajt 1420 fjalëve prej burimi roman dhe 540 fjalëve sllave. Natyrisht, puna e Meyer-it duhet vështruar në lidhje me kohën e tij dhe me rrethanat e jetës së tij (ai vdiq në moshën 51 vjeç dhe vjetët e fundit të jetës ishte i sëmurë). Por edhe një turkolog dhe ballkanolog mjaft i njohur, N. Boretzky, në veprën e tij *Der türkische Einfluss auf das Albanische*, II, të vitit 1976, d.m.th. pas vdekjes së Tahir Dizdarit (1972), ka përfshirë një numër relativisht më të vogël huazimesh turke. Gjithsesi, sipas Boretzky-t (1975, f. 25), "Numri absolut i elementit turk në shqipe ndoshta nuk është më i madh se në gjuhët e tjera ballkanike, por duket se turqizmat në shqipe luajnë (ose luanin) një rol shumë më të madh se në serbo-kroatishte, në bullgarishte ose edhe se në greqishte."⁷ Natyrisht, Tahir Dizdari, si një njohës i mirë i gjuhës shqipe, ishte i vetëdijshtë se një pjesë e madhe e "orientalizmave" të përfshira në Fjalorin e tij nuk ishin më në përdorim të përditshëm në kohën e tij, prandaj ka vënë shpesh

në dukje karakterin arkaik apo nëndialektor të fjalëve të tilla. Për më tepër, të gjithë studiuesit e interesuar kanë vënë në dukje se qysh nga koha e Rilindjes e, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, shumë turqizma a "orientalizma" kanë ardhur duke u zëvendësuar me fjalë shqipe.⁸

Një meritë tjetër e punës së Tahir Dizdarit është se ai në Fjalorin e tij ka vënë në dukje edhe shtrirjen dialektore të disa "orientalizmave". Për më tepër, ai ka shënuar edhe rastet kur këto huazime kanë ruajtur theksimin oksiton të vetë turqishtes në të folmet jugore të shqipes, ndryshe nga ç'ka ndodhur në disa të folme veriore, ku ato e kanë shpërngulur theksin mbi rrokjen parafundore. Është fjala për rastet e tipit *agá* ~ *ágë* (shumësi në të dy dialektet *aga-llar-ë*, por në ciklin e kreshnikëve të Veriut edhe *ág-ë-t e Jutbinës*), *babá* ~ *bábë* (shumësi në të dy dialektet *baba-llar-ë*), *basmá* ~ *básëm*, *sermá* ~ *sérm* < *sérëm*, *teqé* ~ *téqe*, *Hatixhé* ~ *Hatíxhe* (*Tíxhe*), *Paqyzé* ~ *Paqíze* etj. Prania e kësaj dukurie në huazimet turke dëshmon se ky dallim dialektor, i përfutur nga një risi theksimi të disa emrave në të folmet e dialektit verior, nuk është, të paktën, më i vonë se koha e kontakteve të shqipes me turqishten. Por, gjithsesi, kjo risi e të folmeve veriore të shqipes nuk është as aq e hershme, për çka dëshmon theksimi i njëjtë mbarëshqiptar jo vetëm i huazimeve latine, por edhe i huazimeve sllave. Gjithsesi, arsyeja e një risie të tillë theksimi në të folmet veriore mbetet për t'u hulumtuar.⁹

Një punë shumë të mirë ka bërë Tahir Dizdari edhe me regjistrimin e rasteve të shumta në të cilat fjalë të prejardhura janë formuar sidomos me anë prapashtesash turke (si -çi/-xhi, -li/-lli, -qar, -llëk, -çe) të shtuara sidomos temave emërore nga brumi i shqipes. Edhe hulumtimi i kësaj dukurie do të meritonte një trajtim më vete dhe Fjalori i Tahir Dizdarit për këtë jep një lëndë gati shteruese. Jo më pak interes paraqisin rastet në të cilat, fjalët e huazuara nëpërmjet turqishtes, kanë shërbyer për të formuar fjalë të prejardhura me prapashtesa të shqipes, si edhe fjalë të përbëra e të përngjitura brenda shqipes, si p.sh. *çoban-kë*, *çoban-eshë*, *çobançe*, *çoban-o-j*, *çoban-bash*, *çoban-í*, *çoban-ëri* etj., *krye-myfti* etj. Gjithashtu, do të meritonte një trajtim më vete përdorimi i prapashtesave turke dhe i disa fjalëve turke në gjuhën shqipe për qëllime të caktuara stilistike e vërejtje të këtij

tipi nuk janë të pakta në Fjalorin e Tahir Dizdarit. E jo më pak interes paraqit edhe përdorimi i disa “orientalizmave” në shqipe me kuptime që nuk i kanë turqishtja dhe gjuhët e tjera “orientale”. Mjafton të përmend këtu, për shembull, se emri *çoban* në shqipe përdoret edhe me kuptimin e vllahut a të arumunit, kuptim ky që e ka vënë në dukje edhe Tahir Dizdari (f. 177). Të kihet parasysh se ky emër me një kuptim të tillë nuk ndeshet as në turqishte, as në gjuhën burimore, persishte, dhe as në gjuhët e tjera ballkanike, ku ka depërtuar ky huazim.

Dhe së fundi, nuk duhet lënë pa përmendur bibliografia e pasur, që Autori ka konsultuar për qëmtimin, grumbullimin dhe shpjegimin e fjalëve të huazuara, që ka bërë objekt shqyrtimi dhe studimi në Fjalorin e tij. Midis veprave të konsultuara, bien në sy jo vetëm numri i madh i fjalorëve, sidomos dygjuhësh (duke përfshirë edhe Fjalorin latinisht – shqip të Frang Bardhit), por edhe një literaturë e pasur teorike. Gjithashtu, bie shpesh në sy edhe shfrytëzimi i mirë i këngëve popullore dhe i literaturës artistike për ilustrimin e fjalëve të shqyrtuara.

Edhe nga sa u shtjellua përmbledhtas këtu më sipër, del e qartë se *Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe* i Tahir N. Dizdarit është fryt i një pune të gjatë kërkimore dhe përfaqëson një ndihmesë të rëndësishme për studimin e mëtejshëm të evolucionit historik, sidomos të fjalorit të gjuhës shqipe. Kjo vepër mund të shfrytëzohet me dobi jo vetëm nga studiuesit e gjuhës shqipe, por edhe nga turkologët dhe ballkanologët.

BIBLIOGRAFI

1. Boretzky: 1975–1976 = Boretzky, Norbert. “Der türkische Einfluss auf das Albanische. Teil I (1975), Teil II (1976). Wiesbaden.
2. Çabej: 1975 = Çabej, Eqrem. “Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe”. “Studime filologjike” 1975/4.
3. Demiraj: 1999 = Demiraj, Shaban. “Disa zhvillime paralele në evolucionin e shqipes dhe të iranishtes. “Perla” 1999/1.
4. Demiraj: 2001 = Demiraj, Shaban. “Rreth huazimeve

prej burimi turk, arab dhe persian në gjuhën shqipe”
“Univers” 2001/1.

5. Demiraj: 2005 = Demiraj, Shaban. “Rreth huazimeve të shqipes prej burimi persian.” (Kumtesë ende e pabotuar).
6. Dizdari: 1977v. = Dizdari, Tahir N. “Persizmat në gjuhën shqipe”. “Perla” 1997 e vazhdim.
7. Dizdari: 2005 = Dizdari, Tahir N. “Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe”. Tiranë.
8. Haim: 1953 = Haim, S. “Haim’s one volume Persian – English Dictionary”. Teheran.
9. Kononov: 1956 = Kononov, A. N. “Grammatika sovremennogo tureckogo jazyka”. Moskva – Leningrad.
10. Kostallari: 1977 = Kostallari, Androkli. “Rreth depërtimit të turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”. “Gjurmime albanologjike” (Prishtinë) 1977/VII.
11. Krajni: 1965 = Krajni, Anton “Hymja e turqizmave në shqipe dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre”. “Studime filologjike” 1965/1.
12. Meyer: 1891 = Meyer, Gustav. “Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache”. Strassburg.
13. Miklosich: 1888 = Miklosich, Franz. “Die türkischen Elemente in den süd-ost und ost-europäischen Sprachen (albanesisch, rumänisch, bulgarisch, serbisch, kleinrussisch, polnisch) Erste Hälfte”. Wien.
14. Miklosich: 1889. “Über die Einwirkung des Türkischen auf die Grammatik der südosteuropäischen Sprachen”. Wien.
15. Rossi: 1963 = Rossi, Ettore. “Manuale di lingua turca”. Roma.

¹ Tahir N. Dizdari, “Persizmat në gjuhën shqipe”, “Perla” 1997 e vazhdim.

² Shih për këtë çështje edhe Boretzky: 1975, 22v.

³ Ajo ka tetë zanore, duke përfshirë edhe zanoren /y/ dhe një zanore të ngjashme me zanoren /ë/ të shqipes.

⁴ Shih më hollësisht për këtë artikullin tim në "Univers": 2001. Nr. 1, faqe 20 vv.

⁵ Shih Kononov: 1956, f. 47, Rossi: 1963, f. 13-14.

⁶ Shih Haim: 1953, 655.

⁷ "Die absolute Zahl der türk. Elemente im Alb. ist vielleicht nicht höher als in anderen Balkansprachen, es scheint aber, dass die Turzismen im Alb. eine viel grössere Rolle spielen (oder spielten) als im Serbokroat., im Bulgar., oder gar im Griech." Gjithsesi, ky autor në vëllimin II të veprës së tij (1976), f. 9, pohon se nuk ka pasur mundësi t'i përfshijë të gjitha huazimet turke të shqipes në këtë vëllim kushtuar pikërisht fjalorit të këtyre huazimeve, të renditura në faqet 13-146, ndërsa në faqet 147-224 ka përmendur huazimet turke në dialektet e Drenicës, Preshevës, Zadrimës, Dibrës dhe Çamërisë.

⁸ Për mënjanimin dhe zëvendësimin e vazhdueshëm të këtyre huazimeve në gjuhën shqipe shih sidomos artikullin e Anton Krajnit (1965).

⁹ Për theksimin e huazimeve turke në shqipe, shih sidomos Boretzky: 1975, 100vv.